



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO**

---

Numri i lëndës: 2022:234820  
Datë: 07.06.2023  
Numri i dokumentit: 04371161  
Dosja fizike: C-IV-14-3215

N J nga Prishtina.

*Paditësja*

Kundër:

Agjencia Kosovare e Privatizimit, me seli në Prishtinë, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë

*E paditura*

**DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT** (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Mr.sc. Bajram Miftari, me datën 07.06.2023, mori këtë:

**AKTGJYKIM**

I. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses N J dhe VËRTETOHET vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit - Autoritetit të Likuidimit PRN092-0020, i datës 25.10.2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**Rrethanat procedurale të çështjes**

Me datën 25.04.2014, paditësja ka paraqitur kërkesë pranë Dhomës së Posaçme, kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit (në vazhdim: AKP), me të cilën ka kërkuar rishikimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (në vazhdim: AL), PRN092-0200, të datës 25.10.2013.

Pala paditëse e ka titulluar parashtresën si “*kërkesë*”, mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi, konform nenit 35.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pran Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Pala paditëse në padi, ndër të tjera ka theksuar: Me kërkesë kreditore ka kërkuar nga AL, kompensimin e pagave për periudhën 1990-1999, në shumën prej 18,661.69. Autoriteti i Likuidimit kërkesën e parashtruar e ka refuzuar mbi bazën e parashkrimit të kërkesës. Ka pretenduar se vendimi i AL-së është nxjerrë në vërtetim të gabuar te gjendjes faktike dhe shkelje te dispozitave materiale juridike. Në lidhje me konstatimin e gabuar te gjendjes faktike ka theksuar se AL nuk e ka marrë për bazë faktin se është iniciuar procedurë gjyqësore pranë Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar e cila gjykatë pastaj është shuar. Kjo padi e parashtruar me urdhër të Qeverisë së atëhershme është bartur në Gjykatën Komunale në Jagodinë. Po ashtu ka pretenduar se pala e paditur e ka pohuar borxhin, ku përveç kësaj te gjithë punëtorët në vitin 2005, kanë iniciuar procedurë gjyqësore pranë Dhomës së Posaçme te Gjykatës Supreme te Kosovës. Me tutje ka theksuar se AL nuk e ka shqyrtuar fare faktin se pala paditëse ka qene në marrëdhënie pune te rregullt dhe mbi këtë bazë është detyrim i punëdhënësit që punëtorit t’ia kompensoj te ardhurat personale. Si rezultat i konstatimit të gabuar te gjendjes faktike AL ka zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat materiale juridike. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta aprovoj si të bazuar dhe te detyrohet pala e paditur që t’ia kompensoj te ardhurat personale për periudhën shtator 1990-12 qershor 1999, në shumën prej 18,661.69 €. Padisë ia ka bashkangjitur edhe vendimin e AL-së me numër PRN092-0200.

Me datën 17.03.2022.2022, e paditura ka paraqitur përgjigje në padi, ku ndër të tjera ka theksuar: Objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL-së, respektivisht përputhshmëria e tij me Ligjin 04/L-034, për AKP-në. Me nenin 74.2 të atij ligji është përcaktuar se ankesat e dorëzuara në Dhomën e Posaçme kundër vendimeve të AL, duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034. Më tutje, ka ngritur edhe prapësimin e parashkrimit të kërkesës, duke theksuar se me padi kërkohe pagat duke filluar nga viti 1999, ndërsa me nenin 36.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në, është përcaktuar se kërkesat apo pretendimet e pas afatshme, sipas kufizimeve kohore të aplikueshme, do të refuzohen si të pa bazuara. Me përgjigje në padi është propozuar të refuzohet kërkesëpadia, si dhe të vërtetohet vendimi i lëshuar nga AL.

### **Gjendja faktike e konstatuar**

Me nenin 8.1 të LPK- së është përcaktuar: “*Se cilat fakte do t’i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje, e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë te rezultatit të gjithë procedimit. Gjykata me ndërgjegje dhe me kujdes e çmon ç’do provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku*”.

Pala paditëse si provë ka parashtruar shkresën e datës 05.06.1991, drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë; dhe urdhëresën e datës 19.10.2001.

- Pas shqyrtimit të provave të lëndës vlerësimit të tyre gjykata ka ardhur në përfundimin se paditësja me datën 15.08.2007, pranë Autoritetit të Likuidimit të NSH Eximkos, ka parashtruar kërkesë kreditore përmes të cilës ka kërkuar kompensimin e shumës prej 18,661.69 €, në emër të kompensimit të të ardhurave personale nga marrëdhënia e punës në ndërmarrje që i referohet periudhës nga viti 1990 e deri në vitin 1999. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga pala paditëse dhe ka konstatuar se është parashtruar brenda afatit për dorëzimin e kërkesave. AL me vendimin me numër PRN092-0200, të datës 25.10.2013, kërkesën e parashtruar nga pala paditëse e ka refuzuar si të pa bazuar. Vendimin e vet Autoriteti i Likuidimit e ka bazuar në nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, ngase ka konstatuar se kërkesa kreditore e parashtruar nga pala paditëse është e parashkruar. Ishte jo kontestuese në mes të palëve se paditësja nuk ka ofruar shërbime në ndërmarrje për periudhën kontestuese.
- Pala paditëse ka pretenduar se i takon kompensimi për periudhën e lartë cekur, ngase me kohe i është drejtuar Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar fakt që e ka ndërprerë rrjedhën e afatit të parashkrimit të kërkesës. Në anën tjetër pala e paditur ka pretenduar se kërkesa e palës paditëse është e parashkruar bazuar në nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Sipas vlerësimit të gjykatës, si çështje e cila fillimisht duhet shqyrtuar është çështja se a është parashkruar kërkesa kreditore e palës paditëse apo jo.

Gjykata përkujton se është parim i përgjithshëm në procedurën gjyqësore kontestimore, se faktet jo kontestuese nuk është e nevojshme që të provohen nga gjykata.

### **Arsyetimi ligjor**

Procedura gjyqësore pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në vazhdim: Dhoma e Posaçme), është e rregulluar Ligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në Lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji nr. 06/L-086, i publikuar në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 12/27, Qershor 2019), si ligj special. Përveç kësaj, si ligj procedural i përgjithshëm zbatohet Ligji për Procedurën Kontestimore (Ligji nr. 03/L-006), me ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme. Kjo çështje është definuar me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 76, paragrafi 3, ku është theksuar, se *“në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozitë përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”*.

Ligji për Dhomën e Posaçme, neni 74, i jep të drejtën palës (kreditorit në procedurë të likuidimit) që të ushtroj mjetin juridik - ankesën kundër vendimit të AL-së, pranë Dhomës së Posaçme. Sipas të njëjtës dispozitë ligjore, Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë aktgjykim për vërtetimin, shfuqizimin apo ndryshimin e vendimit të AL-së, varësisht prej epilogut të procesit gjyqësor dhe në zbatim të dispozitave ligjore të aplikueshme.

Gjykata fillimisht ka shqyrtuar se a është e nevojshme mbajtja e seancës dëgjimore me palët në procedurë apo çështja mund të vendoset në bazë të materialeve në lëndë. Këtë çështje nuk e adreson Ligji për Dhomën e Posaçme si ligj special, por vetëm LPK si ligj procedural i përgjithshëm. Me LPK, neni 4, është përcaktuar se:

*- Gjykata vendos për kërkesëpadinë pas shqyrtimit të çështjes juridike në seancë të drejtpërdrejtë dhe publike. Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj.*

Një rast të tillë të përcaktuar me të njëjtin ligj ku mund të merret vendim meritore pa pasur nevojë që të mbahet seancë dëgjimore, e kemi të rregulluar me nenin 399 të LPK-së, ku është përcaktuar si në vijim:

- Neni 399.1: Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija.*
- Neni 399.2: Kërkesëpadija është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadija qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.*

Duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë përmendura dhe në zbatim të dispozitave ligjore të cituara më sipër, gjykata ka ardhur në përfundimin se janë përmbushë kushtet ligjore për të nxjerrë vendim meritore (aktgjykim) në këtë fazë të procedurës shkresore dhe se mbajtja e seancës dëgjimore në këtë rast, është e panevojshme.

Siç është potencuar më sipër, e paditura ka paraqitur prapësimin e parashkrimit. Andaj, çështja e parë që është dashur të zgjidhë gjykata ishte ajo se a është kërkesa e parashkruar apo jo. Gjykata, pas shqyrtimit të dosjes së lëndës ka ardhur në përfundimin se nga faktet e treguara apo të prezantuar nga pala paditëse në padi, e që nuk janë kontestuar si të tilla as nga pala e paditur, nuk del themelësia e kërkesëpadiës. Përkundrazi, mbi bazën e të gjitha fakteve siç i ka prezantuar pala paditëse në padi rezulton se kërkesëpadija nuk është e bazuar, për shkakun se kërkesa është e parashkruar.

Pala paditëse, me kërkesën kreditore drejtuar AL-së dhe me kërkesëpadi ka kërkuar kompensimin e pagave të papaguara që i takojnë periudhës kohore 1990-1999. Nga ana tjetër, kërkesën kreditore për kompensim pagash e ka dorëzuar në AL me datën 15.08.2007.

Gjykata potencon se sikurse legjisllacioni që ishte vendosur para viteve 1998/99, ashtu edhe ligjet që janë miratuar pas viteve 1998/1999, e kanë ruajtur afatin tre (3) vjeçar të parashkrimit të kërkesave monetare nga lëmi i marrëdhënies së punës. Me Ligjin për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), neni 608 parashihej se “pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës, do të jetë e parashkruar për tri

vite”. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), i vitit 1978 (Ligj nr. 690), neni 372.1 përcaktonte se *afati i parashkrimit të kërkesave periodike është tri vite, nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë*. Ligji i Punës, i vitit 2010 (Ligj nr. 03/L-212), neni 87, përcakton se *të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*. Edhe LMD i ri, i vitit 2012 (Ligj nr. 04/L-077), neni 353.1, ka përcaktuar se *“Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) ... parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë”*. Nga përmbajtja e këtyre dispozitave ligjore, rezulton se afati i parashkrimit të kërkesave monetare nga marrëdhënia e punës, është tri vite, nga dita e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç.

Nga zbatimi i dispozitave ligjore të lartpërmendura, rezulton se kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të viteve 1990-1999, është parashkruar me kalimin e afatit prej 3 vitesh, që nga arritja e pagave për pagesë. Fakti se kërkesa për kompensim pagash është paraqitur në vitin 2007, tregon se paditësi ka kërkuar kompensimin e pagave, lidhur me të cilat i është parashkruar kërkesa para se ai të aplikonte pran Autoritetit të Likuidimit. Pala paditëse ka pretenduar se ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore të Punës së Bashkuar, mirëpo shkresa e datës 05.06.1991, e cila është dorëzuar si provë nga pala paditëse nuk vërteton pretendimin se sajë se ka iniciuar procedurë gjyqësore pranë Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar. Kjo për faktin se nga përmbajtja e sajë nuk vërteton se kush ishte palë paditëse dhe çfarë kërkohej me të. Pala paditëse nuk ka mundur që të dëshmoj se ka pasur ndonjë ngjarje juridike e cila e ka ndërprerë rrjedhën e afatit të parashkrimit të kërkesës.

Me nenin 360.1 të LMD-së (të vitit 1978) është përcaktuar se me parashkrimin pushon e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Kjo dispozitë ligjore është e natyrës detyruese, prandaj detyrimi që kërkohet me kërkesën e palës paditëse nuk mund të gëzoj mbrojtje juridike, për shkak të parashkrimit të kërkesës.

Përveç asaj që është thënë më sipër, gjykata potencon edhe faktin se paditësi kërkon pagat për një periudhë në të cilën nuk ka qenë i angazhuar në procesin e punës në Ndërmarrje. Paga është rezultat e procesit të punës dhe i krijimit apo zhvillimit të fondit të Ndërmarrjes, ku pastaj një pjesë e atij fondi shpërndahet për pagat e punëtorëve të përfshirë në procesin e punës. Me që paditësja nuk ka qenë punëtorë e Ndërmarrjes që nga viti 1990-1999 dhe nuk ka qenë e angazhuar në punë, nuk janë prodhuar as të drejta dhe detyrime reciproke në mes të saj dhe Ndërmarrjes, në aspektin e pagave.

Rrjedhimisht duke u bazuar në faktet dhe rrethanat e lartë cekura dhe në dispozitat ligjore të cituara më sipër, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Me Ligjin për Dhomën e Posaçme, neni 62, është përcaktuar se vetëm palës së suksesshme në procedurë (palës që e fiton gjykimin), i takon kompensimi i shpenzimeve gjyqësore. Nëse pala e suksesshme nuk i kërkon shpenzimet ose nëse ashtu vendos Dhoma e Posaçme, atëherë secila

palë i bart shpenzimet e veta. Në këtë çështje kontestimore, asnjëra nga palët në procedurë nuk ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve procedurale. Andaj, gjykata ka vendosur që secila palë në procedurë të bartë shpenzimet e veta gjyqësore.

### **Udhëzimi juridik**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim pranë Dhomës së Posaçme, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të tij, e cila i drejtohet Kolegjit të Apelit pranë Dhomës së Posaçme, konform nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Gjyqtari,**  
**Mr.sc. Bajram Miftari**